

KONTRATË SHKËMBIMI

(Pasuri e luajtshme)

Sot më 08.11.2018, ne palët e mëposhtme me vullnetin e tonë të lirë, të plotë dhe në mirëkuptim të ndërsjelltë, redaktuam këtë kontratë:

PALËT SHKËMBYESE:

I. PALA E PARË:

Luan MUÇA, i biri i Shahin, i datëlindjes 05.08.1971, lindur në Skënderbej, Elbasan dhe banues në rruga "Dervish Hima", pall. Nr. 3, ap. Nr. 6, Tiranë, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plote juridike e për të vepruar, mbajtës i pasaportës Nr. BE0431405, Nr. personal H10805062A, zotërues i 100% të aksioneve të shoqërisë "**IMPULS-95**" sh.a., me NUIS **K42619205W**, me seli Durrës, Xhafzotaj, Pikë Karburanti në Autostradën Tiranë-Durrës, Ura e Fllakës, Zona Kadastrale Nr. 3582, Nr. Pasurisë 14/59.

II. PALA E DYTË:

Eduart Seitaj, i biri i Pajtim, i datëlindjes 21.04.1978, lindur në Peshkopi dhe banues në rruga "Mujo Ulqinaku", Nd. 9, Ap. 15, Tiranë, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 027933050, Nr. personal H80421198W, zotërues i 60% të kuotave të shoqërisë "**MALBERG**" sh.p.k., me NUIS **L31308033S**, me seli në Tiranë, rruga "Milito Tutulani", pallati 6, apartamenti 18.

BAZA LIGJORE:

Neni 757 e vijues i Kodit Civil, Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

TË DHËNA PARAPRAKE:

- Pala e parë ka në pronësi këtë pasuri të luajtshme:
Luan MUÇA, është aksionar i vetëm dhe zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë "**IMPULS-95**" sh.a., me NUIS **K42619205W**, me seli Durrës, Xhafzotaj, Pikë Karburanti në Autostradën Tiranë-Durrës, Ura e Fllakës, Zona Kadastrale Nr. 3582, Nr. Pasurisë 14/59.
- Pala e dytë ka në pronësi këtë pasuri të luajtshme:
Eduart Seitaj është ortak dhe zotëron 60% të kuotave të shoqërisë "**MALBERG**" sh.p.k., me NUIS **L31308033S**, me seli në Tiranë, rruga "Milito Tutulani", pallati 6, apartamenti 18.
- Me vendim të asamblesë së aksionarëve të shoqërisë "**IMPULS-95**" sh.a., aksionari i vetëm i kësaj shoqërie ka vendosur të miratohet shkëmbimi i 100% të aksioneve të shoqërisë "**IMPULS-95**" sh.a. të zotëruar nga aksionari i vetëm Luan Muça, me 60% të kuotave të shoqërisë "**MALBERG**" sh.p.k. të zotëruara nga ortakut Eduart Seitaj.
- Me vendim të asamblesë së ortakëve të shoqërisë "**MALBERG**" sh.p.k. ortakët e kësaj shoqërie kanë vendosur të miratohet shkëmbimi i 60% të kuotave të shoqërisë "**MALBERG**" sh.p.k. të zotëruara nga ortakut Eduart Seitaj me 100 % të aksioneve të shoqërisë "**IMPULS - 95**" sh.a. të zotëruar nga aksionari i vetëm Luan Muça.

NENI 1


Objekti

- 1.1. Objekti i kësaj kontrate është shkëmbimi i 60% të kuotave të shoqërisë "**MALBERG**" sh.p.k. të zotëruara nga ortakut Eduart Seitaj me 100 % të aksioneve të shoqërisë "**IMPULS - 95**" sh.a. të zotëruar nga aksionari i vetëm Luan Muça.

NENI 2

Pasuritë e luajtshme objekt shkëmbimi dhe kalimi i pronësisë

- 2.1. 100 % të aksioneve të shoqërisë "**IMPULS-95**" sh.a., me NUIS **K42619205W**, me seli Durrës, Xhafzotaj, Pikë Karburanti në Autostradën Tiranë -Durrës, Ura e Fllakës, Zona Kadastrale Nr. 3582, Nr. Pasurisë 14/59 të zotëruara nga aksionari i vetëm Luan Muça.
- 2.2. 60% të kuotave të shoqërisë "**MALBERG**" sh.p.k., me NUIS **L31308033S**, me seli në Tiranë, rruga "Milito Tutulani", pallati 6, apartamenti 18, të zotëruara nga ortakut Eduart Seitaj



- 2.3. Palët deklarojnë se janë dakord të shkëmbejnë pasuritë e tyre të luajtshme të specifikuara hollësisht më lart.

Konkretisht me nënshkrimin e kontratës në pronësi të palës së parë Luan Muça, do të kalojnë:

- 60% të kuotave të shoqërisë “MALBERG” sh.p.k., me NUIS L31308033S, me seli në Tiranë, rruga “Milto Tutulani”, pallati 6, apartamenti 18,

Ndërsa, në pronësi të palës së dytë Eduart Seitaj do të kalojnë:

- 100 % të aksioneve të shoqërisë “IMPULS-95” sh.a., me NUIS K42619205W, me seli Durrës, Xhafzotaj, Pikë Karburanti në Autostradën Tiranë-Durrës, Ura e Fllakës, Zona Kadastrale Nr. 3582, Nr. Pasurisë 14/59..

NENI 3

Të drejta dhe detyrime të palëve

- 3.1. Palët garantojnë njëra-tjetrën për titullin e pronësisë të pasurive objekt kontrate dhe për saktësinë e dokumentacionit zyrtar, në të kundërt mbajnë përgjegjësi civile për dëmin e shkaktuar.
- 3.2. Palët garantojnë njëra-tjetrën se secila nga shoqërtë është një person juridik i organizuar rregullisht dhe ekzistues në mënyrë të vlefshme dhe që funksionon sipas legjislacionit shqiptar dhe ka të gjitha të drejtat dhe kompetencat për të ushtruar aktivitet tregtar në të cilin është angazhuar dhe të zotërojë e përdorë pasuritë në pronësi dhe në përdorim prej saj. Të gjitha librat e llogarisë dhe bilancet e secilës shoqëri që janë të detyrueshme sipas ligjit në fuqi dhe të gjitha raportet financiare të secilës shoqërisë janë hartuar dhe mbajtur që nga themelimi i tyre, në përputhje me ligjet në fuqi dhe praktikën, si dhe janë korrekte dhe të vërteta në aspektin material sipas legjislacionit në fuqi dhe praktikës.
- 3.3. Palët janë të detyruara t'i dorëzojnë njëra-tjetrës pasuritë objekt kontrate shoqëruar me të gjithë dokumentacionin përkatës;
- 3.4. Palët janë të detyruara t'i dorëzojnë njëra-tjetrës pasuritë objekt kontrate të shkarkuara nga çdo e drejtë apo pretendim i të tretëve.

NENI 4

Të ndryshme

- 4.1. Palët do të depozitojnë këtë kontratë në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- 4.2. Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin për shkak të ekzekutimit të kësaj kontrate. Në rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontrata redaktohet në gjuhën shqipe në tre kopje origjinale, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike.

PALËT SHKËMBYESE

